



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

**Në Komunën e Podujevës DSHMS punën e organizon në Sektorin e Shëndetësisë,
Sektorin Mirëqenies Sociale dhe Qendrën për Punë Sociale**

Raport pune për vitin 2024

Spektori i Shëndetësisë

Në vazhdimësi punën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në sektorin e shëndetësisë mund ta përmbledhim si në vijim:

QKMF në Podujevë është i vetmi institucion shëndetësor publik që përkujdeset për shëndetin e rreth 80 mijë banorëve të komunës së Podujevës. QKMF në përbërje të vet ka 3 QMF, 18 AMF dhe numër të lejuar të punësuarve 246 me zotimin buxhetor 266 në vitin 2025.

- Veprimtaria:

Veprimtaria e QKMF-së përfshinë ofrimin e shërbimeve shëndetësore të KPSH-së për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.

Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Podujevës t'u ofrojnë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse, efikase dhe në vazhdimësi individit dhe familjes në të gjitha fazat e jetës, bazuar në të dhëna shkencore, përmes mjekut familjar si mjek i përzgjedhur i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe njëherit pikë referuese për specialistët, konsulentët në KPSH dhe në nivelet tjera të kujdesit shëndetësor.

Sipas SSSH 2017-2021 dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një mjekë familjar dhe dy infermier-e familjare ofron shërbime shëndetësore për 2000 banorë sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF – së.

- Shërbimet

QKMF kryen këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor:

- Shërbimet e promovimit shëndetësor; përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin brenda institucioneve dhe në komunitet,
- Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese,
- Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike,
- Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent,

- Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike,
- Shërbimet e shëndetit mendor,
- Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjë,
- Shërbimet e shëndetit riprodhues,
- Shërbimet e shëndetit oral dhe parandalues,
- Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijes, kujdesi paliativ si dhe kujdesi shtëpiak bazuar në nevojat e popullatës dhe prioritetet e shëndetit publik,
- Shpërndarjen e barnave nga lista esenciale në barnatoret doracake të rrjetit të KPSH – së.

- Struktura

QKMF me qëllim të ofrimit të përkujdesjes shëndetësore për banorët e vet, organizohet me këto njësi përbërëse:

- Departamenti i Mjekësisë Familjare me këtë përbërje:

Spektori i Mjekësisë Familjare,

Njësia e SISH - it

Njësia e Vaksinit dhe Imunizimit,

Spektori i Shëndetit Oral Preventiv,

Spektori i Kujdesit Urgjent,

Spektori konsultativ dhe Diagnostik:

Shërbimet konsultative (Pediatri, Radiologu, Gjinekologu, Epidemiologu)

Kabineti Radiologjik,

Laboratori,

- Departamenti i Administratës së QKMF-së -Podujevë organizohet në:

Njësia ose Zyra e personelit,

Njësia ose Zyra Juridike,

Njësia ose Zyra për buxhet dhe financa,

Njësia ose Zyra për shërbime teknike.

- Barnatorja Qendrore:

Barnatorja qendrore është njësi organizative e QKMF-së e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve nën ligjore që rregullojnë veprimtarinë farmaceutike.

Në QMF / AMF funksionojnë barnatoret doracake të cilat menaxhohen, furnizohen dhe monitorohen nga barnatorja Qendrore në QKMF.

Nga barnatorja qendrore shpërndahen në QMF, AMF barnat nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga Ministria dhe të përshkruara në recetat unike , nga Mjekët e Sektorit të Mjekësisë Familjare si dhe barnat dhe materiali nga kontrata komunale për furnizim.

- Rrjeti i institucioneve të KPSH të komunës së Podujevës përfshinë:

1- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)

3 – Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF : Lluzhan, Orllan, Kërpimeh)

18 – Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF: Pollatë, Bajqinë, Dobratin, Bradash, Llapashticë, Gllamnik, Dumnicë, Shtedim, Herticë, Shajkoc, Sfeqël, Batllavë, Dyz, Majac, Lupq, Lagjja e Dëshmorëve (Ballofc), Obranqë, Halabak). AMF Dyz dhe Halabak nuk janë funksionale në mungesë të stafit e kjo e fundit në mungesë të kushteve elementare për punë.

- **Këshillmorja për diabet dhe hipertension**

Në kuadër të mjekësisë familjare funksionin edhe këshillmorja për diabet dhe hipertension. Në këtë shërbim janë sistemuar profesionistë shëndetësor të cilët bëjnë matjen e tensionit dhe glikemisë, japin këshilla për menaxhim sa më të mirë të këtyre dy patologjive dhe komplikimeve të tyre, përcjellin gjendjen shëndetësore në vazhdimësi. Në këtë shërbim janë të evidentuar diabetikët insulinë varës të cilët furnizohen me insulina dhe ku furnizimi me insulina nga Ministria e Shëndetësisë ka qenë i mirë.

- **Njësia e Gjinekologjisë dhe Materniteti**

Ky shërbim funksionon 24 orë me staf të mesëm – mami, kurse gjinekologia me orar çdo ditë pune paradite. Në kuadër të kësaj njësie funksionon edhe këshillimorja, ultrazëri. Në këtë shërbim bëhen kontrolla gjinekologjike të të gjitha grupmoshave, administrohet terapi e indikuar nga gjinekologu, jepen këshilla dhe bëhen lindje. Për fat të keq për shkaqe dhe arsye më të ndryshme numri i lindjeve dukshëm është reduktuar krahasuar me periudhat e më hershme (këtë vit kemi pasur vetëm 6 lindje).

- **Trupat e QKMF**

Për përmbushjen e detyrave të veçanta dhe mbarëvajtje të punës në rrjetin e institucioneve të KPSH konkretisht në QKMF funksionojnë edhe këto trupa:

- Këshilli Dretjues i QKMF – së,
- Këshilli Profesional,
- Komisioni Disiplinor ,
- Komisioni i Ankesave
- Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore,
- Dhe mbetet për t'u formuar: Komisioni Etiko – Profesional.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË TË PUNËSUARVE NË QKMF

Numri i të punësuarve, pozitive udhëheqëse, emërimeve politike, të punësuarve nga komuniteti jo-shumicë dhe atyre me nevoja të veçanta të ndara sipas gjinisë (të dhënat bazohen në listën e pagave të muajit dhjetor)	Femra - gra	Meshkuj	Gjithsej
Numri i të punësuarve në QKMF	167	79	246
Numri i të punësuarve në QKMF në pozita udhëheqëse	8	13	21
Numri i të punësuarve në QKMF të emëruar në pozita politike	1	/	1
Numri i të punësuarve në QKMF nga komuniteti jo-shumicë	/	/	/
Numri i të punësuarve në QKMF me nevoja të veçanta	/	/	/

Të dhëna të përgjithshme statistikore për vizitat – shërbimet e kryera në QKMF në vitin 2024

Qendra Mjekësia Familjare (QKMF) numri i vizitave	192617
Emergjencia	59808
Tereni (QMF, AMF) numri i vizitave	44596
Qendra (QKMF) + Tereni (QMF + AMF) + Emergjencia, numri i vizitave	297021
Qendra (QKMF) + Tereni (QMF + AMF) numri i shërbimeve	355627
Totali i vizitave dhe shërbimeve qendër dhe teren	652648

Bazuar në Planin e Punës të vitit 2024 edhe përkundër sfidave dhe vështirësive janë arritur pikësynimet në drejtim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore ndaj qytetarëve por referuar planit të punës të vitit 2024 kanë mbetur të parealizuara synimet: mosrealizimi i Troponinës në mungesë të reagensit si rezultat i procedurave të prokurimit në realizmin e kontratës për furnizim, nuk është realizuar synimi për hapjen e shërbimit për trajtim të shputës diabetike dhe kjo si rezultat i mos sigurimit të një trajnimi adekuat të stafit të mesëm, gjithashtu nuk është arritur zgjatja e orarit të punës deri në ora 23 në QMF Lluzhan dhe Kërpimeh ashtu siç kishim planifikuar dhe e gjithë kjo në mungesë të resurseve humane, riorganizimit të brendshëm rezultat i të cilit është shtuar stafi në emergjencë dhe është zgjeruar orari i punës të kujdesit paliativ dhe obligimeve ligjore të konceptit të mjekësisë familjare (zgjedhja e mjekut familjar).

TË DHËNA – INFORMACIONE PËR SHËRBIMET NË QKMF

QKMF-ja ka punuar me kapacitete të plota bazuar në planin e punës për vitin 2024 edhe përkundër numrit jo të mjaftueshëm me resurse humane dhe shtim të nevojës për shërbime. Janë ofruar shërbime cilësore e gjithëpërfshirëse ndaj qytetarëve-popullatës konform obligimeve bazuar në dispozitat ligjore të Kujdesit Parësor Shëndetësor. E gjithë kjo nuk ishte e lehtë dhe ishte sfiduese por është arritur falë disiplinës e përkushtimit të profesionistëve e që kjo është inkurajuese edhe për marvajtje e rezultate në vazhdim madje edhe me shtim e zgjerim shërbimesh.

E gjithë veprimtaria e QKMF-së në vitin 2024 është bazuar në statutin e ri të QKMF-së me numër protokoli 2026 i cili ka filluar së zbatuari nga data 06.11.2023.

QKMF-ja ka ofruar shërbime të mjekësisë familjare nga ora 07-23 çdo ditë pune, vikendeve dhe festave (kemi shtuar staf, para dite, pas dite dhe në mbrëmje me dy ekipa), kurse nga muaji dhjetor me kujdestari gjatë gjithë natës.

-Emergjenca, materniteti dhe salla e infuzioneve kanë ofruar shërbime 24 orë, kurse nga data 02.12.2024 shërbimi i urgjencës ka kaluar në objektin e ri ku është kompletuar edhe me shërbim radiologjik, laboratorik dhe stomatologjik.

-Specialistika ka punuar çdo ditë pune 07-15 (Pediatri, Radiologu, Gjinekologu, Epidemiologu).

-Vaksinimi ka funksionuar nga ora 07-20 ditëve të punës dhe të shtuneve nga ora 07-15 (Vaksinimi kryhet edhe në çdo qendër shëndetësore të terenit ditëve të punës), sipas orarit zyrtar të atyre shërbimeve në ditët kur punon mjeku.

- Stomatologjia në qendër ka punuar çdo ditë pune nga 07-20, të shtuneve 07-19 dhe të dielave 07-13. Stomatologjia ka funksionuar edhe në QMF Lluzhan, Kërpimeh, Orllan dhe Gllamnik çdo ditë pune para dite, në QMF Lluzhan edhe me kujdestari të shtuneve paradite.

- Janë ofruar shërbime stomatologjike në ordinancën e veçantë për persona me aftësi të kufizuar në katin e parë të mjekësisë familjare.

-Radiologjia ka punuar nga ora 07-23 çdo ditë pune, festave dhe vikendeve, kurse ultrazëri e mamografia çdo ditë pune në orarin e para ditës 07-13, kurse nga muaji dhjetor shërbime radiologjike ofrohen 24 orë edhe në urgjencën e re.

-Laboratori në qendër ka punuar çdo ditë pune, vikendeve e festave nga ora 07-23, kurse nga muaji dhjetor shërbime laboratorike ofrohen 24 orë edhe në urgjencën e re. Në QMF Lluzhan, Orllan, Kërpimeh dhe AMF Gllamnik çdo ditë pune para dite, kurse në QMF Lluzhan edhe me kujdestari të shtuneve paradite.

-Kujdesi shtëpiak-palativ ka punuar çdo ditë pune, festave dhe vikendeve me orar të zgjeruar nga ora 08-23.

-Ka vazhduar programi i vizitave shtëpiake për gratë shtatëzëna dhe fëmijët 0-3 vjeç nga ekipet e trajnuara me automjetin e dhuruar si donacion.

-Kemi realizuar me sukses programin e dializës edhe përkundër shtimit të rasteve.

- QMF-të në Lluzhan, Kërpimeh dhe Orllan punojnë me dy ndërrime dhe kujdestari, këtu ofrohen shërbime të mjekësisë familjare me dy ndërrime, shërbime stomatologjike e laboratorike para dite çdo ditë pune.

-16 AMF janë funksionale me mjek në ato më të mëdha 5 ditë e ato më të vogla 2-3 ditë, kurse me staf të mesëm çdo ditë pune në orarin 08-14:30 (AMF Bradash dhe Gllamnik çdo ditë pune me mjek dhe staf të mesëm, kurse nga muaji dhjetor edhe AMF Dobratin, AMF Llapashticë, AMF Lupq dhe AMF Sfeqël me mjek çdo ditë pune). Në kohë fundit AMF – Herticë ka punuar 1 ditë në javë kurse AMF – Pollatë ka qenë jo funksionale në muajtë e fundit të vitit për shkak të pushimit të lehonisë së motrës të sistemuar atje, tashmë është funksionale me staf.

-Me shtimin e stafit barnatorja qendrore ka ofruar shërbime para dite e pas dite si dhe të shtunave.

-Kemi qenë mirë të furnizuar me barëra, material shpenzues, laboratorik, stomatologjik e radiologjik falë kontratës komunale, planifikimit dhe furnizimit nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë.

-Furnizimi me insulina ka qenë i mirë dhe vazhdon të jetë i tillë.

-Kemi vazhduar me dërgimin e stafit në trajnime të ndryshme ku vetëm në këtë periudhë kohore kemi rreth 80 të trajnuar për tema të ndryshme.

- Kemi pranuar dhe mbikëqyrë nxënës dhe student në praktik profesionale.

-Kemi realizuar vizitat sistematike të fëmijëve në qerdhet publike si dhe vizitat sistematike të të gjithë nxënësve të klasëve të I, V dhe IX të të gjitha shkollave.

- Është kryer vaksinimi i rregulltë sipas kalenderarit të imunizimit për klasën e I, VI dhe XII.

-Kemi bërë pajisjen e shërbimeve si në qendër ashtu edhe teren me aparatura të reja, është bërë trajnimi i stafit për punë me këto aparatura, profesionistët janë pajisur me mjete pune, shërbimet me inventar dhe klima dhe janë krijuar ambiente të mira pune dhe kushte të reja për trajtim të pacientëve dhe punë të profesionistëve.

-Kemi filluar me aktivizimin e SISH-it, por ende larg funksionimit të plotë të tij.

-Kemi aktivizuar sistemin e regjistrimit të hyrje daljeve për punëtorët e QKMF – së, tashmë edhe në QMF Orllan, Lluzhan, Kërpimeh, AMF Gllamnik dhe objektin e ri të shërbimeve diagnostike dhe specialistike.

- Kemi asistuar me ekipet tona në çdo kërkesë të Policisë, klubeve sportive dhe eventeve të ndryshme.

- U kemi ndihmuar shumë pacientëve me aparate oksigjeni, paterica, shtretër, karroca invalidore etj.

-Përmirësimet në infrastrukturë, pajisjet me aparatura e mjete pune, furnizimet e rregullta, trajnimet e stafit, rendi dhe rregulli i vendosur janë garancë e ofrimit të shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse për qytetarët-popullatën dhe lehtësim për profesionistët për ofrim të shërbimeve.

Njësit Shëndetësore Primare me Pajisje dhe Shërbime Laboratorike sipas Udhëzimit Administrativ

1. QKMF- Podujevë- Laboratori Hematologjik dhe Biokimik Qendror
2. QKMF- Podujevë- Laboratori Specialistik Baciloskopik
3. QMF- Lluzhan_ Laboratori Hematologjik dhe Biokimik
4. QMF-Orllan Laboratori Hematologjik
5. QMF- Kërpimeh Laboratori Hematologjik dhe Biokimik
6. AMF- Gllamnik Laboratori Hematologjik dhe Biokimik
7. Urgjenca Mjekësore Laboratori urgjent (Hematologji, glikemi, troponin)

Niveli i Pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral

- Gjithsej numri i ekipeve të mjekësisë familjare (1 mjek specialist dhe 2 infermier) - 54 ekipe (27 ekipe mjek specialist familjar dhe 27 ekipe me mjek të përgjithshëm)
- Gjithsej numri i ekipeve të Stomatologjisë (1 doktor i stomatologjisë dhe 1 teknik/asistent) - ekipe me stomatolog (2 ekipe stomatologjike me ass. dentar dhe 7 ekipe stomatologjike me infermier/e)

Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit

- gjithësej fëmijë të planifikuar për program të imunizimit - 7145
- gjithësej fëmijë në program të cilët janë imunizuar - 6439

Ofrimi i kujdesit shëndetësorë specifik për gra dhe fëmijë

- Ofrimi i shërbimit specialistik për gra dhe fëmijë në QKMF- shërbimi specialistik për gra-femra nga një gjinekolog dhe shërbimi specialistik për fëmijë nga një pediatër si dhe ekipa e programit të vizitave shtëpiake për gra shtatzëna dhe fëmijë 0-3 vjeç

TË DHËNAT STATISTIKORE PËR SHËRBIMET E KRYERA

Të dhëna statistikore të vizitave – shërbimeve sipas sektorëve – njërive të Mjekësisë familjare qendër

Mjekësia familjare qendër (QKMF) numri i vizitave (Totali)	192617
Emergjenca numri i vizitave	59808
Emergjenca – numri i rasteve jashtë shërbimit + të transportuar	3289
Kujdesi Paliativ, nr. i vizitave	9568 vizita
Programi për grate shtatëzana dhe fëmijët 0 – 3 vjeç, numri i vizitave	1152
Stomatologjia numri i vizitave	6365
Shërbimet specialistike (Pediatria, Epidemiologjia) numri i vizitave specialistike	465
Gjinekologjia, materniteti, vizita/ lindje	5421 vizita / 6 lindje
Mjekësia familjare – kujdestaria numri i vizitave	11917
Laboratori – numri i pacientëve që kanë kryer analiza	26029
Radiologjia – RTG, Echo, Mamografi	18685
Shërbimi i insulinave	657 insulinvarës
Këshillëmorja për Diabet dhe HTA	4536
Infuzionet në qendër – nr. i rasteve me infuzion	23436
Lidhëtorja, numri i pacientëve	11043
EKG , Inhalim në mjekësi familjare	2594
Baciloskopi + PPD numri i rasteve të kryera	652
Vaksinimi i rregulltë / kundër gripit	15241
Vizitat sistematike të fëmijëve në qerdhet publike	189
Vizitat sistematike të nx. Të kl. I, V, IX	3132
Shërbimi i dializës	30 pacientë

Të dhëna statistikore të vizitave në Teren (QMF dhe AMF)

Lluzhan - numri i vizitave	18985
Kërpimëh - numri i vizitave	6968
Orllan– numri i vizitave	2009
Batllavë – numri i vizitave	2471
Ballofc - numri i vizitave	813
Obranqë - numri i vizitave	465
Dobratin - numri i vizitave	907
Bajqinë – numri i vizitave	459
Bradash - numri i vizitave	2749
Pollatë – numri i vizitave	10

Lupq – numri i vizitave	1144
Majac – numri i vizitave	428
Sfeqël – numri i vizitave	1460
Shajkofc – numri i vizitave	473
Llapashticë – numri i vizitave	858
Gllamnik – numri i vizitave	3160
Dumnicë – numri i vizitave	1120
Shtedim – numri i vizitave	93
Herticë – numri i vizitave	24
Gjithsej vizita në teren (QMF dhe AMF)	44596

Projektet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2024

Aktiviteti	Vlera e Projektit	
Furnizim me Barna (Lot 1 Furnizim me barëra dhe material stomatologjik, Lot 2 Furnizim me reagensë dhe material laboratorik dhe Lot 3 Furnizim me filma rëntgeni)	443,706.00 Euro	Projekt në realizim
Furnizim me pajisje- Sistemi i menaxhimit të radhës për pacientë (menaxhimit të radhës për pacientë në QKMF)	9,150.00 Euro	Projekt i realizuar
Furnizim me Oksigjen	6,750.00 Euro	Projekt në realizim
Furnizim me pajisje mjekësore (Aparatura për stomatologji, laborator, emergjencë dhe për shërbime tjera, aparatura për nevoja të trajnimeve dhe mjete pune të domosdoshme për profesionistët)	106,450.00 Euro	Projekt i realizuar
Servisimi i pajisjeve mjekësore (servisim të pajisjeve radiologjike, stomatologjike dhe laboratorike)	35,000.00 Euro	Projekt në realizim
Renovimi i Objekteve Shëndetësore Lot 1 Renovimi në QKMF dhe teren (Ngjyrosja e kulmit të QKMF-së, ndërrimi i dymve në hyrje të mjekësisë familjare, vendosja e shkallëve emergjente, rregullimi i ndarseve të qelqit kah shkallët e brendshme të mjekësisë familjare, rregullimi i hyrjeve për persona me aftësi të kufizuara dhe banjosh për ta, renovimi i brendshëm dhe jashtëm i AMF Llapashticë dhe rregullimi i oborrit, rrethojat në pjesën ballore të AMF Dumnicë, rrethojat në pjesën ballore të QMF Kërpimëh, rrethimi i oborrit të AMF Obrançë, rrethimi i oborrit të AMF Dobratin, rregullimi i oborrit të AMF Bajçinë, furnizimi me pisha-drunjë dekorativ për nevoja të oborreve në	90,000.00 Euro	Projekt në realizim

qendër dhe teren Lot 2 Renovimi, zgjerimi dhe izolimi i hapësirave të radiologjisë, rikonfigurimi i pajisjeve radiologjike dhe furnizimi me dozimetra për shërbim dhe staf punues		
Furnizim me Dokumentacion Mjekësorë	55,000.00 Euro	Projekt në realizim
Ndërtimi i Objektit të Urgjencës	1,700,000.00 Euro	Projekt i realizuar
Furnizim me karrikë gjinekologjike për persona me nevoja të veçanta	2,500.00 Euro	Projekt në procedurat e prokurimit
Mirëmbajtja e laurës		Projekt në realizim
Servisimi i automjeteve		Projekt në realizim
Larja e automjeteve		Projekt në realizim
Mirëmbajtja e nxemjeve dhe klimave		Projekt në realizim
Furnizim me qelqe		Projekt në realizim
Furnizim me derivate, lëndë djegëse.		Projekt në realizim
Ndërtimi i qendrës rezidenciale		Në ndërtim e sipër
Renovimi i objektit të QPS		Projekt i realizuar

Sektori i Mirëqenies Sociale

Subvencionet

- Është bërë thirrje publike për **OJQ-të** në shumë prej **20,000.00 €** në bazë të: RREGULLORES MF - NR – 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE:
 - Komision ka vendosur që të jenë tre përfitues nga OJQ
 1. OJQ Handikos 9,500.00 Euro
 2. OJQ Autizmi 8,500.00 Euro
 3. OJQ OFAP 2,000.00 Euro
- Komisioni i ngritur nga Kryetari i Komunës gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 ka vlerësuar rastet dhe kërkesat individuale për ndarje të subvencioneve si në vijim:

Numri i kërkesave të parashtruara ku përfshihen edhe rastet e prekura me kancer të gjirit është : 1853 kërkesa, 689 janë të aprovuara ku prej tyre 362 janë femra.

- Në bashkëpunim me OJQ-të humanitare janë ndihmuar 350 familje me pako ushqimore dhe 50 persona janë duke u ndihmuar me shujtë ditore në bashkëpunim me donatorë

Strehim:

Sa i përket qështjes së banimit, gjatë vitit 2024, në banim social duke banuar kemi gjithsej 134 familje (112 familje janë duke banuar në shtëpitë në Lagjen e Dëshmorëve, shtëpi të cilat janë të ndërtuara gjatë viteve paraprake nga Ministria në bashkëpunim me Komunen e Podujevës ku këto familje janë perzgjedhe nga Komisionet për perzgjedhjen e familjeve. Këto familje janë nga familjet e Dëshmorëve, veteranëve të luftës dhe familje raste sociale. Gjithashtu dhe 22 familje raste sociale janë duke banuar në Lagjen Shqiptarët për Shqiptarët, shtëpi të ndërtuara donacion në bashkëpunim me Komunën).

Nuk kemi asnjë familje të re e cila është vendosur në banim social gjatë vitit 2024, apo që ka liru banimin social, por kemi 22 familjet në Lagjen Shqiptarët për Shqiptarët të cilave iu është vazhduar kontrata njëvjeçare për banim.

Numri i familjeve të regjistruara në Komunë që kanë aplikuar për shtëpi apo banim social gjatë vitit 2024 është 34. Në listën prioritare pritëse të familjeve në nevojë dhe që i plotësojnë kushtet për banim social janë 6 familje.

Në vazhdimisht kemi kërkesa për ndërtim të shtëpive, strehim apo për përmirësimin e kushteve të banimit nga familjet raste sociale dhe gjithashtu nga familjet e Komuniteteve jo shumicë. Këto familje vizitohen nga komisioni i DSHMS-së për të evidentuar gjendjen e tyre socio ekonomike dhe të banimit, por në mungesë buxheti nuk kemi pasë mundësi të ju ndihmojmë për përmirësimin e banimit të tyre, por janë në listë prioritare nëse kemi ndonjë donacion apo projekt nga Komuna.

Gjatë vitit 2024 Komuna e Podujevës ka nënshkruar marrëveshje me Shoqatën Jetimat e Ballkanit për ndërtimin e 5 shtëpive për familjet në nevojë. Komisioni ka vizituar të gjitha familjet aplikuese, dhe ka perzgjedhë familjet, shtëpitë janë në përfundim të sipër. Ndër këto 5 familje, një familje është perzgjedhë nga Komuniteti ashkali. 3 shtëpi janë në fazën përfundimtare të mobilimit. Ndërtimi i këtyre shtëpive është duke u bërë në pronat private të familjeve. Gjithashtu.

Për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe të banimit, një familje nga Komuniteti është ndihmuar me vendim të veçantë, dhe nga donatorët, ndihmë për renovim të dhomave, rregullim të banjos sistemit të ujit dhe rrymës, dhe mobilim të shtëpisë.

Rastet të cilat janë me shumë prioritet për banim janë identifikuar dhe jemi në pritje të buxhetit apo ndihmës nga donatorët.

RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN KORRIK-GUSHTË NË QENDRËN PËR PUNË SOCIALE NË PODUJEVË

Shërbimet Sociale

Në Qendrën për Punë Sociale në Podujevë gjegjësisht në Shërbimin Social trajtohen raste të cilave u ofrohen Shërbime Sociale të drejtpërdrejta për përfituesit e këtyre shërbimeve.

Qendra për Punë Sociale në Podujevë-Shërbimi Social ka trajtuar raste përgjatë gjashtë muajve si në vijim:

- Dhunë në Familje kemi trajtuar 83 raste;
- Fëmije me aftësi të kufizuara kemi 36 raste të reja, ndersa gjithësej nën menaxhimin e Shërbimit Social janë 156 raste;
- Palë të tjera kemi pasur raste prej tyre:
- Shpallja e personit të vdekur kemi 4 raste
- Vërtetim mbi zotësinë e veprimit kemi 598 raste;
- Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës kemi 20 raste ;
- Vërtetim mbajtës i fëmijëve kemi 15 raste;
- Konstatime zyrtare kemi 19 raste;
- Të mitur në konflikt me ligjin kemi 37 raste të reja;
- Kerkese për adoptim të fëmijëve pa kujdes prindëror kemi 3 raste;
- Besim i fëmijëve kemi 6 raste;
- Keshilla martesore kemi 20 raste.

Shërbimi i Asistencës Sociale

Shërbimi i Asistencës Sociale punon dhe vepron në kuadër të QPS-së – DKSHMS KK Podujevë duke e zbatuar Ligjin e Skemës Sociale 2003/15 .Gjatë kësaj periudhe të punës punëtorët e këtij Shërbimi janë angazhuar që në mënyrë sa më profesionale të u ofrojnë shërbime qytetarëve në nevojë të cilët në mënyra të ndryshme kanë kërkuar shërbime.

Në vazhdim ju paraqesim të dhënat për punën në periudhën kohore Korrik -Nëntor të vitit 2024

Për Ndihmë Sociale gjatë kësaj periudhe kohore nga qytetarët janë bërë 14 kerkesa të reja për ndihmë sociale, prej tyre 11 në kategorinë e I ,dhe 3 në kategorinë e-II.

Prej tyre kerkesa janë pranuar 11 dhe 3 janë refuzuar.

Kemi 551 familje shfrytëzuese të Asistencës Sociale.

-Në kategorinë e –I- janë 446 familje

-Në kategorinë e –II- janë 105 familje

Riaplikime janë gjithsejt: 949

Janë bërë 16 kerkesa për rishqyrtim, prej tyre janë të gjitha pozitive.

Komisionit për ankesa pran MPMS-së në Prishtinë

Jane drejtuar 29 ankesa, ku prej tyre te aprovuara jane 11, ndërsa 18 janë të refuzuara kurse 3 në procedurë.

Lëndet e dërguara në komision mjekesor në DNS Prishtinë gjithësejt janë 393 prej tyre 342 janë aprovuar 50 refuzuar plotsim 1 lëndë.

Ndërsa, sa i përket ATK kemi pasur 13 shfrytëzues të asistencës sociale të cilët kanë përfituar në mënyrë të jashtëligjshme.

Pranë QPS-në Podujevë është bërë një kërkesë për ndihmë të njëhershme të cilat janë dërguar në DNS, në procedurë janë 5 lëndë.

Zyrtaret e Shërbimit për Asistencë Sociale - prej muajit shtator janë duke punuar, monitoruar dhe vlerësuar projektin për reformën sociale nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ku nga kjo reformë kanë aplikuar mbi 4700 familje, në muajin tetor kanë aplikuar 497 familje dhe muajin nëntor kanë aplikuar 249 familje.

18.12.2024

Nr.Prot 02-355/02-0079890/24





Formulari per kerkese apo ankese

Drejtoria/Njesia

Zyra e Kryetarit

Data 18/12/2024

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

Drejtorja e Shendetësisë dhe Mirëqenies
Sociale

Numri personal

7777777777

Adresa e vendbanimit

"Bahri Fazliu"

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

00000000

2. Mënyra e pranimit

Raport

Statusi i lëndës

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

02-355/02-0079890/24

Afati i zgjedhjes

17/01/2025

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Raporti i punes per vitin 2024.

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë Drejtoria e Shendetësisë dhe vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.
Mirëqenies Sociale

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkonit nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: jehona.ajvazi